



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 213/1 dt.20.10.1994

PER
MASAT QE DUHEN MARRE PER PROBLEMIN E KIOSKAVE

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.20.10.1994, pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Drejtori i Urbanistikës të Bashkisë Tiranës për masat që duhen marrë për problemin e kioskave sipas Vendimit Nr.28, dt.06.10.1994,

VENDOSI

1. Drejtoria Urbanistike dhe K.RR.T të mos lejojnë vendosjen e kioskave të tjera në brendësi të unazës së qytetit si dhe në ambjente të tjera të rëndësishme publike.
2. Drejtoria Urbanistike të hartojë dhe paraqesë Këshillit Bashkiak studimin për vendosjen e kioskave në periferi të qytetit, brenda muajit Janar.
3. Këshilli Bashkiak dhe Bashkia e Tiranës të organizojë një tryezë të rrumbullakët me autoritetet që përfaqësojnë, Rendin Publik, Ndërmarrjen e Ujësjetësimit, Ndërmarrjen e Kanalizimeve, Kryetarët e Njësive Administrative dhe Drejtoria Urbanistikës.

KRYETARI

BESNIK PETRELA

Ky vendim është pa firmë.